



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSME SOCIALE DHE RINISË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2024

Lënda: Dërgim informacioni.

Në përgjigje të kërkesës tuaj, me datë 03.06.2024, dërguar Bashkisë Shkodër për informimin mbi çështjet rinore pranë Bashkisë Shkodër, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e informimit” dhe në ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, pas shqyrtimit të kërkesës tuaj e cila ishte në përputhje me kërkesat e ligjeve të specifikuar, ju informojmë si më poshtë;

Bashkia Shkodër zhvillon një seri eventesh dhe organizimesh duke nxitur promovimin dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve, e cila është një çështje e rëndësishme për shoqërinë tonë, pasi të rinjtë janë jo vetëm pasardhësit tanë, por edhe forca e ardhshme e vendit. Investimi në të rinj është investim në të ardhmen.

Bashkia e Shkodrës në vitin 2023 ka pasur një strukturë të përzier që kontribuon për të rinjtë. Në këtë fushë funksionojnë dy drejtori: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik e cila mbështet dhe ka në strukturën e saj të brendshme Qendrën Rinore Publike “Atelie”, që funksionon dhe ofron shërbime për të rinjtë që nga viti 2018 dhe Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve e cila përfshin rininë në aktivitete kryesisht të kulturës dhe sportit. Aktivitetet kryesore, përgjegjësitë dhe koordinimi i delegohen qendrës rinore.

Në mbështetje të të rinjve është krijuar Qendra Rinore “Atelie”, në këtë qendër ofrohen programe dhe aktivitete të diversifikuara në përkrahje të të rinjve, në zhvillimin e tyre personal dhe profesional, si dhe duke i ndihmuar të kultivojnë aftësitë e tyre në një mjedis mbështetës dhe inkurajues.

Në territorin e Bashkisë Shkodër janë të ngritura 12 qendra komunitare “Për Familjen” nga të cilat 7 janë në qytet dhe 5 në njësi administrative, të cilat përveç shërbimeve të tjera pët komunitetin, ofrojnë dhe shërbime specifike orientimi dhe angazhimi për rininë.

Në këtë drejtim, Bashkia Shkodër me anë të buxhetit të saj kontribuon në lehtësimin e infrastrukturës dhe mbulon koston e personelit, kostot operative dhe shpenzimet e mirëmbajtjes së hapësirave të dedikuara. Nëpërmjet bashkëpunimit me donatorë dhe OSHC të ndryshme, aktivitetet realizohen me kapacitetin maksimal që ofron qendra rinore e qytetit. Bashkia Shkodër për vitin 2023 ka pasur 4,496,605 lekë buxhet të dedikuar për rininë.

Numri i punonjësve të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 ka qënë 1013 punonjës, prej ku 520 kanë qënë femra dhe 483 meshkuj. Dy persona meshkuj me aftësi të kufizuara kanë qënë dhe vazhdojnë të jenë të punësuar pranë institucionit tonë. Numri i punonjësve 18-29 vjeç për vitin 2023 ka qënë 35 punonjës, nga ku 15 femra dhe 20 meshkuj. Pjesë të kësaj grup moshe me aftësi të kufizuar, nuk e kemi pasur të punësuar. Bashkia Shkodër ka një të punësuar që i përket grupmoshes 18-29, i cili mbanë pozicion drejtues, punonjësi në pozicion drejtuese është në moshën 28 vjeçare, gjinia mashkull. Femra nuk kemi pasur në këtë grup moshë në pozicione drejtuese dhe as më aftësi të kufizuar.

Bashkia Shkodër është në proces hartimi të “Planit Vendor të Veprimit për Rininë”, i cili është në përputje me “Strategjinë Kombetare të Rinisë 2022-2029” dhe ka synim adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zejet, shtim të aktiviteteve sportive dhe vullnetarizëm.

Një politikë tjetër që Bashkia Shkodër ka ndërmarrur për grupmoshat 18-29 vjeç është ngritja e Këshillit Vendor Rinor (KVR), si organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë për çështjet e rinisë. Këshilli Vendor i Rinisë këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë, vlerëson situatën e të rinjve në zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor dhe propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë.

Në procesin e hartimit të rregullorës së KVR kemi patur mbështetjen e “Palladium Group” në kuadër të projektit “RAYS-RREZET”. Sipas pikës 2 të nenit 10, të ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, janë përfshirë 5 të rinj në Këshillin Vendor Rinor, ku 2 anëtarë janë femra dhe 3 anëtarë janë meshkuj, njeri nga ato i përket personave me aftësi të kufizuara. KVR ka krijuar planin me vjetor të aktiviteteve, deri tani janë realizuar 6 aktivitete.

Bashkia Shkoder ka krijuar një marrëdhënie të mirë me organizatat lokale, ky bashkëpunim është i rëndësishëm për të siguruar që nevojat e të rinjve të adresohen në mënyrë efektive dhe për të krijuar ambiente të shëndetshme dhe frytdhënëse për të rinjtë.

Bashkia Shkodër po punon në vazhdimësi me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ka partneritet me institucione të ndryshme për krijimin e marrëdhënieve, bashkëpunimit dhe financimit në fushën e rinisë. Disa nga organizatat me të cilat bashkia ka marrëveshje partneriteti të cilat zbatohen në Qendrën Rinore “Atelie” dhe janë të lokalizuara brenda qendrës duke i dhënë asaj aktivitete të përditshme janë:

“Save the Children” një organizatë lider humanitare për fëmijë dhe së fundmi që ofron mbështetje për të rinjtë në aspektin e aftësive të buta, orientimit dhe këshillimit, ofron kurse pas shkollës deri në moshën 24 vjeç dhe klasa artizanale (hapësira të dhëna në përdorim nga qendra rinore);

“UNICEF” një agjenci e Kombeve të Bashkuara përgjegjëse për ofrimin e ndihmës humanitare dhe zhvillimore për fëmijët në mbarë botën ka ndërtuar në qendrën rinore një laborator të ri TIK të quajtur “BIBLIOTECH”, një mundësi e shkëlqyer për të rinjtë që të punojnë pa pagesë në internet, promovon internetin e sigurt dhe inovacionin në mënyrën se si studiojnë të rinjtë;

“YEA! – Young Entrepreneurs Albania” një organizatë e fokusuar në mbështetjen e sipërmarrësve të rinj në Shqipëri, duke krijuar aktualisht inkubatorin e biznesit në hapësirat e qendrës rinore, zhvillon orët periodike të paschkollës, ndihmon familjet në nevojë me pagesa mujore dhe ofron konkurse periodike për të rinjtë me synimin për të fituar aftësi menaxheriale për bizneset e ardhshme;

“Europe Goes Local” është një projekt që Bashkia Shkodër është pjesë për të forcuar punën rinore në nivel lokal. Projekti financohet me kontributet e Agjencive Kombëtare pjesëmarrëse, në kuadër të programeve Erasmus+ dhe Korpusit Evropian të Solidaritetit.

Disa nga institucionet e tjera vendore që bashkia bashkëpunon në fushën e rinisë janë: Teatri i qytetit “Migjeni”, trupa e së cilës prej 10 të rinjsh u krijua fillimisht nga Grupi i Aktrimit të Qendrës Rinore “Atelie”, Qendra Kulturore “Pjeter Gaci”, e cila kohë pas kohë shfrytëzon sallën e vallëzimit për provat e tyre; Biblioteka e qytetit “Marin Barleti” me të cilët aktualisht po punojnë për krijimin e Grupit të Leximit; Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive “AKPA” dhe Qendra e Formimit Profesional.

Bashkia Shkodër ka ngritur Qendrën Rinore “Atelie” duke e zbatuar në bashkëpunim me IPSIA ACLI, CODE Partners dhe Bashkinë e Triestes. Rikonstruksioni i Qendrës Rinore u realizua në kuadër të projektit “Rini e fuqizuar, e ardhme e qëndrueshme – PO TË ARDHMES”, financuar nga Programi Italo-Shqiptar i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (IADSA).

Në vitin 2023 perfundoi rikonstruksioni i godinës të ish shkollës “Veterinare”, ku me anë të aplikimit për në projektin “Shërbimet Multi-Funksionale të Shkodrës- Model i përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit” në programin e Konvertimit të Borxhit për Zhvillim, IADSA, financuar nga qeveria Italiane dhe me aplikimin në projektin “Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit” financuar nga skema e granteve të BE për Bashkitë (EU4M) është përfituar financimi për Qendrën Multifunksionale “Xixëllonja”, e cila mundëson shërbime për të rinjtë dhe komunitetin.

Mjetet e komunikimit që Bashkia Shkodër përdor për të përcjellur informacionin janë:

- Faqja zyrtare e Bashkisë së Shkodrës, ku mund të gjenden informacione për projektet, aktivitetet dhe shërbimet bashkiake. Faqja zyrtare e Bashkisë së Shkodrës është: <https://bashkiashkoder.gov.al/>
- Faqja zyrtare e Bashkisë së Shkodrës në Facebook, ku publikohen lajmet, njoftimet dhe informacione të ndryshme lidhur me aktivitetet dhe zhvillimet në bashki. Facebook: <https://www.facebook.com/bashkiashkodres>
- Profili zyrtar i Bashkisë së Shkodrës në Instagram, i cili përdoret për të ndarë foto, video dhe njoftime për ngjarjet dhe aktivitetet në bashki. Instagram: https://www.instagram.com/bashkia_shkoder?igsh=MWh3cjdscjdudmd4Yg==

Mjetet e komunikimit që Qendra Rinore “Atelie” përdor për të përcjellur informacionin mbi çështjet rinore janë:

- Web: <https://shkodrarinore.gov.al/>
- Facebook: <https://www.facebook.com/shkodrarinore>
- Instagram: <https://www.instagram.com/shkodrarinore?igsh=bXNoYXgzODlsMHdj>

Gjatë vitit 2023 janë trajtuar me ndihmë ekonomike mesatarisht 1824 familje në muaj. Nga këto 304 familje janë me krye familjar femra dhe 1520 familje janë me krye familjar meshkuj. Në total përfituesit e ndihmes ekonomike kanë qenë 6959 individë, nga keto 3565 femra dhe 3394 meshkuj; janë trajtuar me ndihmë ekonomike me një mesatare 1156 (në muaj) të rinjë të moshes 15-29 vjeç, nga keto 608 janë femra dhe 548 janë meshkuj.

Numri i përfituesve të pagesës së aftesisë së kufizuar për vitin 2023 ka rezultuar me një mesatare 6072 në muaj, ku përfshihen 4 kategoritë: aftesi e kufizuar, verbëri, para/tetraplegjikë dhe invalid pune, nga keto 2714 janë femra dhe 3358 janë meshkuj.

Gjatë vitit 2023 janë trajtuar me aftesi të kufizur mesatarisht 350 (në muaj) të rinjë të moshës 15-29 vjeç, nga keto 133 janë femra dhe 217 janë meshkuj.

Duke ju falënderuar,

KRYETAR

Benet BECI